



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 060/01-4263/22
Kaçanik, 17.02.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Solemne e Kuvendit të Komunës Kaçanik, për ndër të 14 vjetorit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, mbajtur më 17.02.2022 (e shtunë). Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 10:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë, 27 anëtarë.

Nga ekzekutivi i komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, nënkyetari i komunës- Sabedin Vishi, drejtori e drejtive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Zahir Doda, Qamil Stagova, Dardana Dauti, Pranvera Loku-Zharku, Hafize Sallahu, Suhad Dullovi dhe Sali Malsiu. Nga zyrtarët komunal ka qenë Fatlume Guri-Selimi.

Të pranishëm në këtë mbledhje kanë qenë edhe : Fidaim Fazliu- Përfaqësue i BIK, në Kaçanik, Rrustem Dema- Kryetar i OVL , Kjani Zeneli dhe Ahmet Luma.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes dhe ju falenderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të komunës, për ndërë të 17 shkurtit, ditës së Pavarësisë së Kosovës. Në këtë mbledhje është paraparë ky:

REND PUNE

- 1.Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të komunës;
- 2.Fjala përshëndetëse e Kryetarit të komunës, Besim Ilazi; dhe
3. Fjalë përshëndetëse e përfaqësuesve të subjekteve politike në kuvend.

1.Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të komunës

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, të nderuar anëtarë të Kuvendit, i nderuar Kryetar i komunës, Nënkyetar i komunës, të nderuar drejtor, përfaqësues i BIK dhe musafir të nderuar. Më lejoni të ju drejtohem me një fjalë rasti për këtë mbledhje solemne të Kuvendit, për të shënuar një ngjarje historike në vendin tonë, 14 vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, si një ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë tonë më të re.

Për të arritur deri këtu, u deshën shumë mund e sakrifica, të brezave ndër vite e shekuj, të cilat punuan, luftuan dhe vepruan në formë dhe rrethana të ndryshme për të arritur qëllimin e përbashkët, për çlirim e këtij populli të shumë vuajturndërshekuj.

Andaj për të nderuar të gjithë ata që u flijuan që ne të jetojmë të lirë, kërkojë t'i nderojmë me një minut heshtje

LAVDI!

Republika e Kosovës po mbush 14 vjet të jetësimit të saj, shpallja e pavarësisë më 17 shkurt të vitit 2008, ishte akt historik dhe sublim i të gjitha përpjekjeve dhe luftrave të pareshtura ndër breza ,për liri dhe mëvetësi shtetërore të vendit tonë. Gjej këtë rast solemn të shpreh mirënjohe dhe nderim deri në epijetet për të gjithë ato bijë e bija luftëtare, të luftës sonë të lavdishme çlirimtare me Komandat Adem Jasharin, heronjëve , dëshmorëve dhe martirët, të cilët me gjakun e tyre murosën themelët e shtetit tonë të pavarur.Mirënjohe e thellë për partnerët tanë ndërkombëtar, SHBA dhe NATO, të cilët e kuptuan drejt luftën e popullit shqipëtarë për liri, u rreshtuan krah tij , për të mbrojtur nga gjenocidi serb dhe për t'i sjellur lirin e shumëpritur këtij vendi.

Sot edhe pas pothuajse 22 vite të çlirimt dhe 14 vite të pavarësisë ,Kosova po shënon këtë përvjetor pa protagonistët kryesor të luftës për liri dhe shtetëndërtim: pa ish Presidentin Thaçi, ish kryekuvendarin Veseli, ish kryekuvendarin Krasniqi, deputetin Selimi, luftëtarët Nasimin, Hysniun, Pjetrin dhe Saliun, të cilët po mbahen në qendrën e paraburgimit në Hagë , nën akuzat që çdo ditë po dëshmohen se janë sajuar në kuzhinat e Beogradit, për të njollosur luftën tonë për liri. Ata me krenari edhe atje po mbrojnë luftën tonë dhe presim shpejt t'i kemi në mesin tonë, për festimet e ardhshme sepse pastërtia e luftës sonë është dëshmuar edhe në proceset e më hershme, si në rastin Haradinaj dhe Limaj.

Kosova gjatë këtyre 14 viteve të pavarësisë ka bërë hapa të mëdhenj drejt konsolidimit të shtetit demokratik, drejt ngritjes së institucioneve shtetërore, drejt fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar dhe zhvillimit të gjithanshëm shoqëror dhe ekonomik.Por si çdo fillim, sidomos ai i një kombi të sapo dalë nga lufta, është i vështirë.Andaj Kosovës si në luft edhe sot i duhet bashkuar energjitetë dhe potencialet për të arritur hapin me kohë dhe për të ecur bashk në proceset që po kalon.Ne duhet të mësojmë fëmijët tanë, jo vetëm që ta duan vendin e tyre, por edhe si të pregatiten për të bërë vepra të mëdha për ta.

Edhe në këtë përvjetor vjen fuqishëm zëri i kushtimit nga vitet e rezistencës, nga vargu pambarim i dëshmorëve të lirisë, vjen thirja e Adem Jasharit ,për të mbrojtur fitoret historike, për të kultivuar vlerat e traditës së shkëlqyer të popullit tonë dhe për të përparuar dhe zhvilluar vendin e të parëve tanë.

Ky përvjetor po vjen me të arritura të konsiderueshme edhe në nivelin lokal, në komunën tonë. Këto të arritura nuk duhet të na entuziazmojnë,të na krijojnë emocione vetëkënaqësie sepse ne duhet të punojmë akoma më shum sepse qytetarët kanë nevoja të shumta për një jetë më cilësore dhe më kualitative.Duhet përsëritur edhe njëherë se e gjithë kjo që po bëhet është si rezultat i vepre madhore siç është Pavarësie e Kosovës;

Gëzuar Pavarësinë e Kosovës dhe Lavdi të gjithë atyre që dhanë jetën për këtë ditë!
Faleminderit!

Kryetari i komunës, Besim Ilazi, Qytetarë të nderuar, të respektuara familje të dëshmorëve, të nderuar mysafirë të pranishëm,
Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë dhe privilegjin që me rastin 17 shkurtit – 14 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së vendit tonë, t'ju uroj: Gëzuar Pavarësinë e Kosovës!

Kjo është dita më e shënuar e historisë së Kosovës, që përbledh sakrificën dhe përkushtimin për ta jetësuar idealin e gjeneratave të tëra për një shtet.

Kjo është dita e Kosovës - dita kur krejtjmë lirinë, një lindje të re për qytetarët e shtetit të ngritur mbi gjakun e shumë të rënëve për lirinë e vendit. Kosova sot është një realitet i pakthyeshëm, një shtet i ndërtuar nga sakrifica e shumë brezave, një paqe e fituar pas një lufte të gjatë e të rëndë, që vetëm historia do të na kujtoj më së miri.

Sot po e shënojmë së bashku ditëlindjen e nëntë të shtetit tonë, si festën më të madhe dhe më të rëndësishme për për çdo qytetar që e do vendin e tij, që e do flamin e simbolet shtetërore. Sot jemi bashkuar për të shënuar nëntë vjetorin e pavarësisë së Republikës së Kosovës, të vendit tonë të dashur, ditëlindjen e shtetit tonë.

Qytetarë të dashur,

Shteti ynë lindi me shumë mundime. Për të u bë një sakrificë e madhe njerëzore me shumë vuajtje. Nëpër histori populli shqiptar kaloi shumë periudha të vështira, ndërsa Shpallja e Pavarësisë së Kosovës mund të konsiderohet si njëra ndër ngjarjet më të mëdha historike që nga Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Shtendërtimi i Kosovës kaloi nëpër periudha të vështira e veçanërisht gjatë kohës së okupimit serb. Format e ndryshme të rezistencës së popullit shqiptar në Kosovë nuk sollën përmirësimin e gjendjes pasi përball ishte një pushtues që nuk njihte format demokratike të rezistencës, ndërsa në fund të viteve të 90-ta doli në skenë UÇK-ja e udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari. UÇK-së iu bashkuan një armatë e tërë vullnetarësh nga të gjitha trojet shqiptare, por e përkrahur edhe nga shtetet demokratike të prirë nga SHBA-të dhe NATO që bashkërisht e detyruan pushtuesin serb të tërhoqet nga trojet tona.

Të nderuar të pranishëm,

Kosova e pavarur e demokratike sot feston Datëlindjen e saj të nëntë. Sa herë që vjen kjo ditë, ne me të drejtë kujtjmë historinë tonë të lavdishme. Kjo ditë na përkujton njëkohësisht edhe sakrificat dhe vuajtjet e popullit tonë, luftën e brezave për çlirim e vendit, që u jetësua në saje të gjakut të dëshmorëve dhe martirëve në luftën e UÇK-së.

Para 9 viteve, Kuvendi i Kosovës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, më 17 shkurt 2008 shpalli Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran. Kuvendi i Kosovës shpall Kosovën republikë demokratike, laike dhe multiethnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtës së barabartë sipas ligjit. Duke garantuar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijimin kushteve e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

Pas shpalljes së Pavarësisë, njohje të menjëherëshme erdhën nga shtetet më të fuqishme të botës, si SHBA, Britani e Madhe, Franca, Italia, Turqia, etj. Ndërkohë që sot Kosova është njohur ndërkombëtarisht nga më shumë se 100 vende të botës demokratike, ndërsa vlen të përmendet suksesi i jashtëzakonshëm i Kosovës në sportin ndërkombëtar, pranimi në UEFA dhe në FIFA, kurse madhështinë e këtij suksesi e begati pjesëmarrja dhe fitorja e artë e xhudistes Majlinda Kelmendi në lojërat olimpike.

Të nderuar pjesëmarrës të këtij evenimenti festiv

Jemi të bindur që do të kemi edhe shumë e shumë ngjarje në muajin shkurt e muajt e tjerrë, që do ta pasurojnë kalendarin e festave dhe ngjarjeve me të cilat do të krenohet populli shqiptarë. Urojmë që sa më shpejtë të kemi një datë ku do ta festojmë integrimin evropian, një datë me perspektivë euroatlantike, që do të shënonë kulmin e arritjeve kombëtare shqiptare, Kosova e Shqipëria si dy shtete të forta në Bashkimin Evropian si dhe në organizata të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

Të nderuar të pranishëm,
Secili nga ne duhet të ndihemi krenar me të arriturat tona të përbashkëta, ndërsa merita u takon dëshmorëve, veprimtarëve nëpër breza të lëvizjes kombëtare, por edhe tërë popullit që bëri rezistencë dhe luftoi robërinë.

Edhe ne si institucione komunale, jemi duke u munduar që vazhdimisht të forcojmë institucionet e administratës komunale, të ndërtojmë një infrastrukturë të mirëfilltë për përmirësimin e mirëqenies se qytetarëve. Jemi të vetëdijshëm se ende kemi shumë punë për të bërë, por nëse qëndrojmë të bashkuar dhe në fryshtë e bashkëpunimit edhe sukseset nuk do të mungojnë. Të gjithë së bashku mund të bëjmë më të mirën për vendin tonë, të hapim rrugën e prespektivës evropiane dhe moderne. Kjo rrugë me vete bart obligime e zotime, por me punën tonë dhe me përkrahjen e miqve tanë, do të arrijmë t'ia dalim me sukses sepse është vullneti i qytetarëve tanë dhe amaneti ndër breza.

Padyshim, Dita e Pavarësisë është ditë festë, ditë gjëzimi. E ndajmë këtë ditë me më të dashurit tanë për të festuar dashurinë tonë më të madhe – dashurinë tonë për Kosovën, këtë èndërr gjeneratash që ne kemi fatin dhe përgjegjësinë ta jetësojmë.

Gëzuar Kosovë!

Gëzuar qytetar të Republikës së Kosovës

Lavdi dëshmorëve dhe gjithë të rënëve të cilët bënë të mundur që ne sot të festojmë shtetësinë e Kosovës

Ju faleminderit

Znj.Fitore Vishi, I nderuar Kryetar, z. Besim Ilazi, të nderuar: nënkyetar, z. Sabedin Vishi, Kryesues i Kuvendit, z. Kemal Murseli, Kolegë dhe kolege – asambleist, Drejtori të drejtive komunale, të nderuar të pranishëm,
Jam e privilegjuar të më lejoni që me këtë rast, si një ndër zërat e kuvendit, të ju përshëndes me urimin më të përzemërt: Gëzuar Festën e Pavarësisë së Kosovës!

Sot, shënojmë 14-vjetorin e ngjarjes më të veçantë të historisë sonë kombëtare – të 17 Shkurtit 2008, kur deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të zgjedhurit e popullit, e shpallën Kosovën Shtet të Pavarur dhe Demokratik.

Ditë e cila, pas Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, renditet më madhorja në mbi 100 vjetët e fundit, e cila vvetetiu na rikthen kujtesën edhe në kohë të shkuara, sa të dhimbshme, me vuajtje e sakrifica, aq heroike e të lavdishme, me rrënjet në gjakun e dëshmorëve të kombit.

Në driten zhvillimi historik, edhe më parë ishin bërë përpjekje, sarifica e flijime për lirinë e Kosovës, sikundër edhe ngjarjet e përgjakshme dekada me radhë në 50-vjetëshin e dyte të shekullit të kaluar, si edhe përpjekjet dhe aktet institucionale të vitit të '90-të: Deklarata Kushtetuese e Kushtetuta e Kaçanikut...

Porse epoka e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me heroin legjendar Adem Jashari, ishte epoka më e zjarritë e më ndritshme e historisë së Kosovës, për lirinë dhe Pavarësinë e saj.

Siç është e lavdishme dhe për mirën e njohje të përjetshme edhe ndihma luftarake e NATO-s, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet tjera demokratike dhe aleate, pasuar edhe me misionin e shenjtë politiko-ushtarak e paqësor në Kosovë edhe sot e më tej.

Në saje të këtyre vlerave patriotike, humane, ushtarake e miqësore, edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, me vullnet të lirë, e shpalli Kosovën shtet Sovran e të Pavarur, më 17 Shkurt 2008. Sovranitetin e së cilës tanë e identifikojmë edhe me simbolet unike shtetërore, ndërkohë që jemi njohur e pranuar edhe nga më shumë se 116 shtete të botës.

Të nderuar të pranishëm, udhëheqje e nderuar,

Prandaj sot kemi obligimin e patjetërsueshëm për ndërtimin e jetës në paqe, gjithsesi si detyrë dhe përballje shumëfish më e lehtë se sa dje në frontet e luftës.

Kështu sendërtojmë porosinë e dëshmorëve dhe gjithë të rënëve për liri, kështu përbushim obligimin tonë për veten dhe trashëgimtarët tanë, dinjitozë edhe për Festën e Pavarësisë.

Urime dhe gëzuar më se një herë 17 Shkurtin – Ditën e Pavarësisë së Kosovës!

Frymëzuar nga liria, urojmë dhe ju faleminderit për suksese të reja!

z.Agim Mani, Faleminderit! I nderuar kryesues i Kuvendit, i nderuar Kryetar i komunës, të nderuar kolegë asambleist ,të nderuar përfaqësues të organizatave të veteranëve, përfaqësues i BIK dhe të gjithë të pranishëm. Ju uroj 17 Shkurtin,14 vjetorin ,Ditën e Pavarësisë së Kosovës. Nga grupi jonë parlamentar i LVV, fjalën ja kaloj z.Adnan Reka.

z.Adnan Reka, Të nderuar anëtar të KK, të nderuar pjesëmarrës të kësaj seance, Sot më 17 shkurt, Kosova është veshur me petkun festiv, shënon 14 vjetorin e pavarësisë së saj. Gjatë kësa periudhe, Kosova pati një përparim të konsiderueshëm, por jo përparimin e duhur kur kemi parasysh gjendjen në të cilën ajo e trashëgoi nga e kaluara dhe gjendjen që u krijua pas pavarësisë deri tani.

Gjithsesi, para shtetit të ri të Kosovës u paraqiten shumë sfida të natyrave dhe preukopimeve të ndryshme, por nuk besoj se ato do do të jenë më të mëdha, më të vështira dhe më të paarritshme se sa ato që kaluam deri te Pavarësia.Sigurisht, edhe “vuajtjet” dhe “sakrificat” do të jenë më të “buta” se ato që përcollën këtë rrugëtim të gjatë shumëdekadash- me kryengritje, djegie e shkatërrime;me internime, burgosje e dëbime; me demonstrate, helmime, vrasje e vale refugjatësh; me trishtim fëmijësh, maltretim pleqsh, përdhunim grash e ekzekutim burrash.

Dhe, sado që ne mundohemi të themi diçka më shumë përmes një fjalimi, ne asnjeherë nuk do të arrijmë të përfshijmë gjithë historinë aq të bujshme që ka Kosova.Sepse nuk ka fjalim që mund ta përshkruaj guximin dhe angazhimin e vazhdueshëm për çlirim dhe bashkim kombëtar, heroizmin dhe luftën e brezave të personifikuar në figurën e Bajram Currit dhe Hasan Prishtinës, Ukshin Hotit dhe Adem Jasharit, Agim Bajramit dhe Qamil Ilazit. Sepse nuk ka fjalë që arrinë të artikuloj drejt të vërtetën e plotë mbi dhimbjet tona shekullore, mbi eksodin e muhaxhirëve të Toplicës, mbi masakrën e Tivarit, për dhembjen e minatorëve të Stan Tërgut, për helmimin e fëmijëve, masakrën e Rakocit, apo kampet e Bllacës e Stankovecit.

Dhe kur të kemi parasysh këtë që u përmend, si dhe shumë gjëra tjera që mbetën pa thënë, atëherë nuk ka si të mos kaploj ky siklet, kur dëgjon dikë të ofrojë ”Asociacion mbi baza etnike, shkëmbim territoresh apo Open Ballkan”. Besoj që Kosova ka kapacitet të mjaftueshëm politik e intelektual, për t'u ballafaquar me shumë dinjitet me të gjitha sfidat të cilat do të gjenden para saj në misionin e ngritjes së shtetit Sovran e demokratik, duke respektuar vlerat positive të shoqërive të avancuara, por asnjeherë duke nëpërkëmbur kushtetutën dhe vullnetin e qytetarëve të saj.

Me 17 shkurt ne nuk mund të mos i kujtojmë me mirënjoyje të thellë të gjithë dëshmorët, invalidët dhe veteranët e UÇK-së, si dhe miqt tanë që kontribuan aq shumë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Sepse ,së pari ishte pushka e UÇK-së ,pastaj erdhën aeroplanët e NATO-s, tanë duhet puna dhe përkushtimi jonë, pastaj ndihma e aleatëve.

Liria dhe pavarësia nuk duhet të pasurojë dhe forcojë individët, por shtetin dhe komunën, sepse në fund të fundit, suksesi jonë matet me aftësitë tona, për të ofruar siguri për punë e jetë, të drejtë për ujë e ajër të pastër, të drejtën për shkollim e shërim, për prone dhe privatësi.

Pabarazia shoqërore, varfëria, korrupzioni e krimi i oranzuar, janë kërcënim i vazhdueshëm për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës,

Prandaj, duhet të punojmë më shumë e më drejtë të forcojmë shtetin dhe komunën, ta rrisim mirëqenien e ta garantojmë sigurinë për ne dhe për brezat që vijnë pas.

Uroj që Kosova e pavarur e demokratike të zhvillohet pandalshëm dhe të përballet sukseshëm në luftën e saj diplomatike, sa më shpejt ta tejkalojë pandeminë dhe t'i jap hov zhvillimit ekonomik të vendit.

Gëzuar 17 shkurti, gëzuar pavarësia e Kosovës!

Ju faleminderit.

zpj.Ardita Rrahmani, I nderuar kryetar i komunes, I nderuar kryesues I kuvendit, te nderuar drejtor,kolege asambleiste, te nderuar qytetare dhe gjithe ju te pranishem ne kete salle.

Me lejoni qe ne emer te grupit parlamentar te Lidhjes Demokratike te Kosoves fillimisht te ju uroj secilin per 14 vjetorin e shtetesise dhe pavarsise te Republikes tone te perbashket Republike kjo e cila asesi se mund te paramendohej te ishte e tille siq edhe eshte pa ata te cilet qofte me pene e qofte me gjene me sublime qe paten jeten, e dhane pa u kursyer asnjehere. Data e 17 Shkurtit nder te tjera duhet te jete edhe nje dite perkujtimi per te gjithe ata burra e gra, mesimdhenes e mjeke, bujq e minatore, intelektual ,djem e vajza te reja qe rezistuan nder vite ndaj agresorit.

Me krenarine me te madhe sot duhet kthejme ne memorie edhe kontributin e qytetareve te Kacanikut ne ndertimin e histories se re te Republikes nisur nga viti '46 pjestareve te Levizjes Nacionale Demokratike Shqiptare ne krye me Fahri Shurdhani, Hilmu Shehu, Shefki Reka, Hajrush Shurdhani, Abaz Ejupi, grapi I vitit '68, Sali Bajra, Bedri Kyqyku, Selim Hoxha, Latif Nallbani, demostratat e vitit 81- grapi I studenteve me Hysen Shurdhani, Avdullah Callaku, Naser Tusha, Ekrem Kyqyku, Fatushe Sopa, Mihane Hasani Buzhala Suzane Bytyqi.

Historia vazhdon te shkruhet edhe ne fillim vitet e 90, Levizja ne krye me Hebib Shehun, Bedri Kyqyku, Xhemail Krasniqi, Mejdi Dalloshi, Misim Sopa, Zahir Doda, Ismail Raka dhe intelektuale te tjere te kohes, ku nder te tjera keta jane prijesit e organizimit te shpalljes se kushtetutes se Kacanikut ne Shtepine e Kultures, me kryetar te kuvendit z.Ilaz Ramajli.

I gjithe ky kontribut dhe mund sa e sa vjeqar drejt Pavarsimit te shtetit pasohet nga Presidenti Historik Ibrahim Rugova dhe lufta e Ushtrise Clirimtare te Kosoves,komandantet e zones tone, Qamil Ilazi e Agim Bajrami, deshmoreve dhe martireve te rene qe sot te jemi ketu ku edhe jemi.

Ne kete dite te madhe kremte per shtetin tone tashme 14 vjeqar, duhet te I jemi mirenjohes edhe miqve tane te perhershem, Shteteve te Bashkuara te Amerikes dhe shteteve te Bashkimit European, per perkrahjen e vazhdueshme kundrejt formimit dhe zhvillimit te Republikes se Kosoves.

Rruja jonë drejt përfundimit të ndërtimit të shtetit është sa e gjatë aq edhe me përgjegjësi, prandaj ne gjeneratat e Pavarësisë së Kosovës, e kemi borxh që ta kryejmë atë me nder dhe perkushtim.

Te punojme aq fort, sa gjeneratat te cilat do te vijne pas nesh me mburrje te thone se jane paraardhesit e tyre ata qe e ben kete shtet me te mire per te jetuar dhe te jene krenar me veprat e sotme tona qe do lene gjurmë per te ardhmen e tyre.

Prandaj, urime ky peryjetor dhe uroj qe shenimin e peryjetorit tjeter te e presim nen familjen e madhe te Bashkimit European, dhe sot uroj te festoni nje dite te bukur ne kete kremte te madhe.

z.Ekrem Livoreka, I nderuar Kryetar, i nderuar Kryesues të nderuar Asambleist/e , të nderuar tē pranishëm.

Kam nderin që përmes Kuvendit Komunal tē ju uroj ditën e pavarësisë së Kosovës tē gjithë Shqiptarëve kudo që janë. Lavdi e përjetshme tē gjithë dëshmorëve tē Kombit, respekt familjeve tē dëshmorëve, invalidëve tē luftës dhe gjithë atyre që kontribuan për lirinë që sot e gjëzjmë ne .

Vetëm duke kujtuar e nderuar tē djeshmen, e rrespektojme dhe nderojme Kosoven e sotme tē pavarur.

z.Agim Çaka, Po takohemi sot me rastin e 14 vjetorit tē shpalljes së Pavarësisë së shtetit tonë. Po takohemi si tē zgjedhurit e qytetarëve tanë për tē kujtuar këtë datë historike e cila padishim se do tē jetë ndër datat më tē rëndësishme tē historisë shqipëtare edhe pse ne që ishim dëshmitarë direkt tē kësaj ngjarje tē madhe më duket se po e kalojmë këtë ngjarje duke mos i dhënë vendin dhe rëndësinë e merituar por që jam më se i bindur se gjeneratat e ardhshme do

ta vlersojnë me shumë respekt këtë datë të madhe dhe sigurisht që do të shprehin dëshirën e madhe të tyre të kishin jetuar në këtë kohë.

Ata do të mburren me të parët e tyre për guximin dhe luftën e pakompromis e të pandalur deri në arritjen e qëllimit final. Ata nuk do të janë dëshmitarë të brrylave politik se kush ishte i pari, kush e nisi e kush e mbaroi, kush dha më shumë e kush më pak por thjeshtë ata do të festojnë me krenari sikurse brezat tanë që po festojnë shpalljen e pavarsisë së Shqipërisë duke kujtuar figurat e kohës të cilët ishin akter të aktivitetit politik e patriotik.

Për këtë periudhë kohore, nga shpallja e pavarsisë së Kosovës e deri më sot kam hasur ne tre sloganë mjart interesante të qëlluara dhe të cilat mendoj se janë të qëndrueshme në çdo kohë dhe çfarëdo rrethane.

I pari është "LIRIA KAEMER".

Shumë e vërtetë që Liria ka emër dhe ai është gjaku i dëshmorëve, lufta e ushtarëve të UCK's dhe mundi e sakrifica e madhe e popullit në përgjithësi.

Slogani I dytë është " ME HAJNA NUK KA SHTET"

Edhe kjo shumë e vërtetë. Hajni nuk është i dobishëm as për shtëpinë e vet e lëre më ti besohet ndonjë detyrë me pergjegjësi shtetërore të çfarëdo niveli.

Këtu e kam fjalën për hajnat të cilët hajninë e kanë në gjak brez pas brezi dhe jo për paragjykimet dhe shigjetimet e pabazuara me qëllim të njollosjes dhe baltosjes së figurave të ndryshme të cilat shpesh herë bëhen viktimi e propagandave dashakeqe të qarqeve të ndryshme të cilat gjithmonë kanë punuar në dëm të shtetit dhe gjithmonë janë të gatshëm të krijojnë destabilitet dhe mjegull në skenën politike.

Gjithsesi pajtohem që hajnat, kushdo që janë ata të ndalen, të izolohen dhe të dërgohen aty ku e kanë vendin pa patur as një mundësi më të voglën që të kenë kontakt me botën e lirë e cila dëshiron të jetë e qetë dhe të jetojë të punoj e të fitojë me djersë.

Slogani i tretë, gjithsesi mjart i rëndësishëm për mendimin tim është një thënje e një mikut tim të madh që " SHTETI NUK PROVOHET".

E që në fakt kjo ka qenë një shprehje e përgjithësuar sepse jo vetëm shteti por asnjë punë me përgjegjësi publike nuk duhet të jetë pjesë e provave politike sepse provat në këto raste mund të janë me pasoja katastrofale dhe dëme të pariparuara për shtetin dhe për shoqërinë në përgjithësi.

Gjithsesi që në këtë rast vlenë thënja : " Punës gjeja njeriun dhe jo njeriut punën", e që përfat të keq te ne në shumicën e rasteve po ndodh kjo e dyta.

Prandaj, të nderuar të pranishëm duke pas parasysh gjithmonë se:

LIRIA KA EMER ,ME HAJNA NUK KA SHTET dhe SHTETI NUK PROVOHET duhet të punojmë të gjithë së bashku pa dallime partiake me qëllim që këto përvjetore të na gjejnë më të bashkuar, më të fortë dhe gjithsesi më të zhvilluar në të gjitha aspektet si në arsim, shëndetësi, kulturë ,zhvillim ekonomik në mënyrë që ne dhe gjeneratat pas nesh ta duam këtë vend, të kemi dëshirën të jetojmë në këtë vend dhe ta shijojmë lirinë dhe shtetin për të cilin punuam dhe sakrifikuam brez pas brezi.

Për fund , gëzuar 14 vjetori I Pavarësisë për të gjithë dhe na priftë e mbara në sfidat tonë të ardhshme në mënyrë që fëmijëve tanë tu ofrojmë mundësinë të ndihen të sigurtë në vendin e tyre dhe pranë njerëzve të tyre.

Faleminderit

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, Nëse dëshiron edhe dikush tjetër të marrë fjalën, urdhëroni. Nëse jo atëher të gjithëve ju uroj 17 Shkurtin, festën e Pavarësisë së Kosovës. Nën organizimin e Kryetarit të komunës, në ora 10:40 do të ketë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve, ndërsa në ora 11:30 do të ketë Akademi Festive, te Shtëpija e Kulturës "Xheladin Kurtaj"

Procesmbajtës

Arbnora Kuqa



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

**Nga Mbledhja Solemne e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, mbajtur
me 17 Shkurt 2022:**

1. Kemal Murseli, *Burri*,
2. Brahim Imishti....., *Hudi*,
3. Hamide Luma*Tekija*,
4. Kadri Krivenjeva, *Kadri*,
5. Fitore Vishi,....., *Fitore*,
6. Rrustem Zenuni,....., *Rrustem*,
7. Edon Baftiu*Edon*,
8. Selajdin Troni*Selajdin*,
9. Fatmir Bunjaku*Fatmir*,
10. Bashkim Krasniqi, *Bashkim*,
11. Florina Lika-Vishi, *Florina*,
12. Lejla Muhamheri-Çaka....., *Lejla*,
13. Agim Mani, *Agim*,
14. Kadrije Lika-Troni, *Kadrije*,
15. Adnan Reka, *Adnan*,
16. Naim Beça, *Naim*,
17. Raif Kasa, *Raif*,
18. Ernesta Krasniqi,....., *Ernesta*,
19. Bashkim Luma*Bashkim*,
20. Arta Avdiu, *Arta*,
21. Arditra Rrahmani, *Ardita*,
22. Besnik Salihu, *Besnik*,
23. Betim Shala,....., *Betim*,
24. Arlinda Rakoci-Raka....., *Arlinda*,
25. Rabije Sallahi....., *Rabije*,
26. Ekrem Livoreka....., *Ekrem*,
27. Agim Çaka....., *Agim*.